



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.2.2025

Nr: 143

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA KOMBËTARE KONSERVATORE ALBANIA”, ME KRYETAR Z. KUJTIM GJUZI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1128 Prot., datë 19.02.2025, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me kryetar Z. Kujtim Gjuzi.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

“Partia Kombëtare Konservatore Albania” nëpërmjet Kryetarit, Z. Kujtim Gjuzi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 10.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me initiale “PKKA.”, me Kryetar Z. Kujtim Gjuzi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Data: 24.2.2025 Nr: 143  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me Kryetar z. Kujtim Gjuzi, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Kombëtare Konservatore Albania” me shkronja nistore “PKKA”, me adresë: Rruga "Stavro Vinjao", Pll. 054, H. 1, Ap 14, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Kujtim Gjuzi, me adresë: Rruga "Stavro Vinjao", Pll. 054, H. 1, Ap 14, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Rozher Prifti, me adresë: Rruga "Dervish Hatixhe", Pll. i Ri, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Kadri Muka, me adresë Mukje-Krujë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

#### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me kryetar Z. Kujtim Gjuzi, me shkronjat nistore “PKKA”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**